

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse Elon Musk mund të jetë njeriu më i rrezikshëm në botë/ Rrëfimet tronditëse të ish-partnereve të milia rderit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/pse-elon-musk-mund-te-jete-njeriu-me-i-rrezikshem-n-e-bote-rrefimet-tro-i584949
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 11:50:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 11:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d01af41c9f4c6324c9dfbb81d2cc1672eeb97e517faad04dadbb0a056bd9ded7
TEKSTI	81d7d97b4916731adf641d99645172eb1b205a5f2fb137a9e6027e99346c230c
PAMJA	87053d383cd458aeb3fc3db7b0d05122de6512ff01f5f6111751e5837cf6b342

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3861f20faa6af70f724911cb91b9cf94598dfa2a47a62836a4e09d2d524154bc
E MËPARSHMJA	a601107c935f32d4722590e9859dfc9f20d881bfbe774c8f36b2804c89cae38a
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3861f20faa6af70f724911cb91b9cf94598dfa2a47a62836a4e09d2d524154bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

Ie Ish-ambasadori i SHBA-se: Strategjia perëndimore për të “rregulluar” Serbinë ka deshtuarBritani, rinisin fluturimet: Dësa aeroporte ishin bllokuar pas defektit në kontrollin e tratikutPas 15 vitesh fundit

Pse Elon Musk mund të jetë njeriu më i rrezikshëm në botë/ Rrëfimet tronditëse të ish-partnereve të miliarderit

9 Shtator 2026, 13:46Lifestyle TEMA



Pse Elon Musk mund të jetë njeriu më i rrezikshëm në

Nga Alison Boshoff, Daily Mail

Elon Musk është njeriu më i pasur në botë dhe, ndoshta, edhe më i fuqishmi. Ai u rrit si djali i një modeleje dhe një inxhinieri elektromekanik në Pretoria të Afrikës së Jugut, përpara se të studionte në Universitetin e Pensilvanisë dhe më pas në Stanford, ku nisi karrierën e tij të famshme në teknologji.

Por, sipas nënës së një prej fëmijëve të tij, ai është gjithashtu një “mitraloz sperme”, i vendosur për të krijuar një legjion me mini-Muskë përpara një “lufte civile”, duke lënë shtatzënë çdo grua të re të krahut të djathtë që i kërkon këtë.

Gruaja e parë, Justine Wilson, e cila ka gjashtë fëmijë me të, thotë:

“Ndjej se ne, gratë, jemi pak a shumë të zëvendësueshme për të. Kam dëgjuar se ai na quan ‘mbarështuese’.”

Ish-e dashura Ashley St. Clair, me të cilën Musk ka një djalë, Romulus, të lindur në shtator 2024, tha:

“Ai më tha se donte të krijonte një legjion fëmijësh përpara luftës civile. Kishte mesazhe në Twitter nga vajza të cilave u kishte ofruar të bëhej babai i fëmijëve të tyre. Është si një mitraloz sperme në mesazhet e tij direkte.”

Idea e Armagedonit duket se zë një vend të rëndësishëm në mendjen e Musk, 55-vjeçarit që qëndron pas Tesla-s dhe SpaceX.

Megjithatë, duket se ai është i mbrojtur nga alarmi real, pasi gjithashtu duket se beson se realiteti është vetëm një simulim dhe se makineritë thjesht na kanë mbajtur ne njerëzit si “kafshë shtëpiake”, një pikëpamje që, sipas pretendimeve të trajtuara në dokumentar, ai ia ka komunikuar edhe shkencëtarit britaniko-kanadez të kompjuterëve dhe fituesit të Nobelit, Geoffrey Hinton.

Nëse e gjithë kjo ju duket e jashtëzakonshme, këto nuk janë aspak të vetmet pretendime tronditëse që bëhen në dokumentarin e ri, “Musk”, me një kohëzgjatje prej pothuajse katër orësh, i cili u shfaq premierë në Festivalin e Filmit në Venecia.

Në film dëgjojmë gjithashtu pretendime se Musk ka gënjyer për bizneset e tij për të rritur çmimin e aksioneve të tij.

Mes pretendimeve të përmendura është edhe ai se makinat e tij “vetëdrejtuese” mund të funksionojnë pa mbikëqyrjen e shoferit, diçka që, sipas dokumentarit, është lidhur me rreth 60 vdekje dhe një numër të madh padish në SHBA.

Një tjetër pretendim lidhet me planin e tij për të kolonizuar Marsin, i cili thuhet se ka qenë “i afërt” prej rreth një dekade.

“Mashtrimi klasik”

Pastaj është edhe “mashtrimi klasik”, që lidhet me pretendimet e vitit 2013 se pronarët e makinave elektrike Tesla mund të zëvendësonin baterinë me një tjetër të karikuar brenda pak minutash, “më shpejt se sa mund të mbushje një makinë me benzinë”.

Kompania përfitoi 11 miliardë dollarë, rreth 8 miliardë paund, nga kreditë e karbonit në Kaliforni si rezultat, por nuk pati kurrë një mundësi të përhapur për ta realizuar këtë skemë në mënyrën se si u shit publikut.

Autori Cory Doctorow thotë në film:

“Ishte si t’i tregojë dikujt një rrotull me monedha të vogla, me një kartëmonedhë prej 100 dollarësh sipër.”

Në dokumentar dëgjojmë gjithashtu pretendime të reja se Musk është i vendosur për dominimin e botës përmes satelitëve të tij Starlink.

Aktualisht janë rreth 11 mijë satelitë në orbitë, të cilët kontrollojnë aksesin në internet në të gjithë globin.

Po ashtu ngrihet pretendimi se ai mund të ketë mbledhur të dhëna për qytetarët amerikanë gjatë periudhës së DOGE dhe se “do t’i përdorë këto të dhëna për të korruptuar zgjedhjet e ardhshme afatmesme”.

DOGE ishte periudha e shkurtër kur Musk ishte pjesë e rrethit të ngushtë të presidentit Donald Trump, duke drejtuar Department of Government Efficiency, i cili premonte të shkurtoje 2 trilionë dollarë, rreth 1.5 trilionë paund, nga buxheti federal.

Në fund, kjo nismë u cilësua si një dështim pa dhëmbë.

DOGE arriti të shkurtoje vende pune dhe ndihma të huaja, por nuk pati asnjë ndikim në deficitin kombëtar të SHBA-së dhe Musk u largua pas katër muajsh, duke thënë se qeveria ishte “e pandreqshme”.

Koha e shkurtër e Musk në DOGE shqyrtohet gjithashtu në film.

St. Clair, një shkrimtare dhe influencuese 28-vjeçare, e cila u njoh me Musk në X përpara se të kishte fëmijën e tij, u tregon autorëve të dokumentarit se Musk ishte çuditërisht i bindur se Trump do të fitonte zgjedhjet e vitit 2024.

Ajo thotë se Musk u largua nga festa e natës së zgjedhjeve në Mar-a-Lago shumë përpara se të shpallej rezultati.

“Ai tha: ‘E dija këtë prej orësh’. Shkalla e sigurisë që kishte, nuk e kisha parë kurrë më parë”, tregon ajo.

Dokumentari shqyrton gjithashtu blerjen e Twitter-it, tashmë X, në vitin 2022, i cili më pas humbi 80 përqind të vlerës së tij.

Musk thuhet se ishte “jashtëzakonisht i shqetësuar” për dokumentarin përpara shfaqjes së tij në Venecia.

Gjatë konferencës për shtyp, St. Clair pretendoi se ai i kishte ofruar 40 milionë dollarë, rreth 30 milionë paund, që të mos mernte pjesë në dokumentar.

Muskut iu dha mundësia të komentonte, por ai refuzoi të bëhej pjesë e filmit.

Reagimi i tij më pas, i publikuar në X, ishte thjesht: “LMFAO”, një shprehje që nënkupton të qeshurën me të madhe.

Ai mund të pretendojë se e gjen qesharake gjithë këtë vëmendje, por personat që flasin në dokumentar, përfshirë gruan e tij të parë, disa ish-miq dhe një ish-koleg në NASA, besojnë se ai mund të jetë njeriu më i rrezikshëm në botë, përveçse më i pasuri.

“Unë jam Alfa në këtë marrëdhënie”

Një prej viktimave të hershme të qëndrimit brutal të Musk ndaj marrëdhënieve njerëzore, sipas dokumentarit, është Justine, gruaja e tij e parë, me të cilën u martua në vitin 2000.

Ajo kujton: “Teksa kërcenim në dasmën tonë, Elon më tha: ‘Unë jam Alfa në këtë marrëdhënie’. Ai vazhdimisht më kujtonte se çfarë më mungonte. Më tha se nëse do të isha punonjësja e tij, do të më pushonte nga puna.”

Dy vite pas martesës së tyre tetëvjeçare, djali i tyre i parë, Nevada Alexander, vdiq nga sindroma e vdekjes së papritur të foshnjës, kur ishte vetëm 10 javësh.

Në një postim në Twitter, Musk kishte shkruar se e kishte mbajtur djalin në krahë ndërsa ai vdiq dhe se kishte ndier rrahjet e fundit të zemrës së tij.

Por në film, Justine thotë se ishte ajo që po mbante Nevada-n në atë moment, në spital.

Më pas ajo pati binjakë përmes fertilizimit in vitro dhe më pas trinjakë.

Megjithatë, familja e lumtur që ajo kishte ëndërruar nuk u materializua kurrë.

“Kishte një ndjenjë distance dhe, për të qenë e sinqertë, një ndjenjë përcëimi nga ana e Elonit.

“Ishte luftë, paqe, luftë, paqe. Në marrëdhënien time me Elonin mësova termin ‘gaslighting’.”

Brenda një muaji nga ndarja e tyre në vitin 2008, Musk u martua me aktoren britanike relativisht të panjohur Talulah Riley – në atë kohë 25 vjeç, ndërsa ai 41.

Ai u divorcua prej saj, u martua sërish me të dhe më pas u divorcuan përsëri.

Ata nuk patën fëmijë.

Më pas ai nisi një marrëdhënie me këngëtarën kanadeze 30-vjeçare Grimes, emri i vërtetë i së cilës është Claire Boucher.

Marrëdhënia nisi me postime flirtuese dhe pseudo-intelektuale në Twitter dhe çifti bëri daljen e parë publike së bashku në Met Gala në New York, në maj 2018.

Djali X lindi në vitin 2020.

Në atë kohë, Grimes e përshkroi partnerin e saj si “një person super interesant”.

Por atë vit nisën të shfaqeshin edhe shenjat e transformimit të Musk.

Ai deklaroi se “përemrat janë të këqij” dhe se fjala “cis”, e përdorur për një person identiteti gjinor i të cilit përputhet me seksin biologjik, ishte një “fyerje”.

Grimes mbeti e tronditur dhe shkroi:

“Nuk mund të mbështes urrejtjen. Të lutem, ndalo. E di që kjo nuk është zemra jote.”

Por, sipas dokumentarit, ishte.

Musk nisi të shprehte disa pikëpamje seriozisht kontroverse.

Një ish-mik thotë se kombinimi i pandemisë së Covid-it dhe “varësisë” së Musk nga popullariteti i tij në X e ndryshoi atë si person.

Në film, autori dhe neuroshkencëtari Sam Harris thotë:

“Ai filloi të sillej në mënyra që ishin të pakuptueshme për mua.”

Gazetarja e teknologjisë Kara Swisher thotë:

“Ai mendon se është thjesht një qenie më e lartë.”

“Virusi i mendjes woke”

Në dhjetor 2020, Musk u zhvendos në Teksas dhe hapi një fabrikë të madhe Tesla në Austin.

Sipas artikullit, rreth 50 milionë dollarë u derdhën në reklama televizive për një grup presioni të krahut të djathtë dhe kundër progresivizmit, Citizens for Sanity.

Musk foli për “virusin e mendjes woke” dhe e fajësoi atë për vendimin e fëmijës së tij Xavier, nga martesa e parë, për të tranzicionuar dhe për të jetuar si grua me emrin Jenna në moshën 18-vjeçare.

Ish-gruaja Justine thotë:

“Ishte e dhimbshme ta shihja duke vuajtur. Ai nuk u përpoq kurrë t’i rregullonte gjërat – kjo nuk është në natyrën e tij. Nëse një marrëdhënie priset, atëherë priset. Ajo duhej të luftonte vërtet për të ndjekur rrugën e saj.”

Sipas saj, Musk i kishte thënë një ditë:

“Sigurohu që Jenna ta dijë se sa shumë e dua.”

“Të nesërmen ai i ndërpreu sigurimin shëndetësor”, pretendon Justine.

Binjakët me Shvon Zilis dhe fëmijët me Grimes

Në këtë pikë, në horizont u shfaqën komplikime të tjera.

Shvon Zilis, drejtoreshë operacionesh në kompaninë Neuralink të Musk, pati binjakë me të përmes një nëne surrogate në nëntor 2021.

Kjo ndodhi vetëm një muaj përpara se të lindte vajza e tij me Grimes, gjithashtu përmes një nëne surrogate.

Ajo u quajt Exa Dark Siderael.

Musk shkroi në Twitter:

“Po bëj më të mirën për të ndihmuar krizën e nënpopullimit. Rënia e lindshmërisë është rreziku më i madh që përballet qytetërimi.”

Në atë kohë, Grimes dhe Musk ishin ndarë, por marrëdhënia e tyre mbeti “fluide”.

Gjatë një periudhe ndarjeje, Grimes paraqiti një kërkesë në prill 2022 për të “përcaktuar marrëdhënien prindërore” me Musk – një përpjekje ligjore për të përcaktuar zyrtarisht nënën dhe babanë e një fëmije.

Brenda disa javësh nga lindja e fëmijës së tyre të tretë, Techno Mechanicus, i njohur si Tau, në qershor 2022, Musk paditi Grimes për të “vendosur një marrëdhënie prind-fëmijë” me tre fëmijët.

Kjo ndodhi pasi ai mësoi se dy fëmijët më të vegjël nuk do të ktheheshin në shtëpinë e tij në Teksas dhe se Grimes po i mbante në Kaliforni.

Ai mbajti me vete djalin X.

Grimes iu kundërpërgjigj me një padi, duke kërkuar kujdestarinë fizike kryesore për të tre fëmijët dhe kujdestari të përbashkët.

Menjëherë pas kësaj, Grimes iu drejtua publikisht Musk në X, duke kërkuar mundësi për të parë djalin X, pasi pa një fotografi të Musk me Shivon Zilis dhe dy fëmijët e tyre.

Sipas artikullit, ajo kishte mësuar për lindjen e tyre vetëm përmes një raportimi të faqes amerikane të lajmeve Business Insider.

Në një seancë gjyqësore në gusht 2024 për të përcaktuar kujdestarinë, Musk tha se fëmijët ishin vendosur në Austin dhe ndiqnin shkollën atje.

St. Clair thotë:

“Shihja ndërveprime që Elon kishte me Claire [Grimes] dhe që ishin shqetësuese. Claire i shkruante duke iu lutur për një situatë me X-in e vogël dhe ai thjesht i thoshte: ‘Po të bllokoj’. Ai ia mori atë foshnjë.”

St. Clair shton se, pas lindjes së Romulus, marrëdhënia e saj romantike me Musk kishte përfunduar.

“Ai ishte shumë i sjellshëm, por që nga momenti kur pata fëmijën tonë, gjithçka u zhduk”, thotë ajo në dokumentar.

Marrëveshja prej 15 milionë dollarësh

Jared Birchall, krahu i djathtë dhe ndërmjetësi i Musk, u dërgua për të arritur një marrëveshje me St. Clair në formën e një “marrëveshjeje për mbështetjen e fëmijës”, e cila përfshinte klauzola që e pengonin atë të fliste për Musk.

Marrëveshja kapte një shumë prej 15 milionë dollarësh, rreth 11 milionë paund, si pagesë fillestare, plus 100 mijë dollarë, rreth 74 mijë paund, në muaj.

Në një regjistrim audio mes Birchall dhe St. Clair në dokumentar, ajo pyet:

“A e kanë firmosur një të tillë edhe nënat e tjera?”

Pasi i thuhet po, ajo përgjigjet:

“Ato nuk duken të lumtura.”

Birchall përgjigjet:

“Nuk mendoj se një muzikant i droguar është i aftë të gjejë lumturinë e vërtetë. Mendoj se Shivon herë pas here gjen kënaqësi. Elon është shumë i sjellshëm dhe bujar, por kur një nënë e fëmijëve të tij dhe një grua të cilës i ka besuar vendos të ndjekë rrugën ligjore, kjo gjithmonë çon në një rezultat më të keq për gratë.”

Pasi St. Clair refuzoi të firmoste, pagesat e saj kaluan nga 100 mijë dollarë në muaj në 40 mijë dhe më pas në 20 mijë dollarë.

“Ai ishte inteligjent dhe i suksesshëm, por ishte definitivisht i çuditshëm”, thotë ajo tani për Musk.

“Një herë ishim bashkë dhe ai po e zinte gjumi me një podcast të ndezur për Kublai Khan.”

Sipas legendës, perandori mongol i shekullit XIII dhe nipi i Genghis Khan kishte 47 djem.

“Ai është i çmendur dhe shumë i fuqishëm”

Sam Harris, podkaster i krahut të djathtë dhe ish-mik i Musk, thotë:

“Po jetojmë në një botë ku psikopatologjia dhe çrregullimi neuropsikologjik i një personi po përkthehen në pasoja masive në politikën, ekonominë dhe gjeopolitikën tonë.”

“Është krejtësisht e çmendur që kemi një person që është kaq kaotik – që nuk është zgjedhur nga askush – dhe që ka kaq shumë pushtet.”

Alex Gibney, regjisor i dokumentarit, është dakord.

“Njerëzit supozojnë se, për shkak se është shumë i pasur, ai nuk është i çmendur. Por gjëja e frikshme mund të jetë që ai është i çmendur dhe është shumë i pasur dhe i fuqishëm. Ky është sinjali i alarmit që filmi po jep.”

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

U kodit me shprehësi nga U.S. Smith, ekspertin. Do shprehësi që "Qasur" me si i llogarit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.